



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/18
Datë:11.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për hartimin e draftit të Kodit Civil (në tekstin e mëtejme: Komisioni)
2. Për anëtarë të Komisionit, emërohen:
 - 2.1. Prof. Dr. Hajredin Kuçi, Ministër i Drejtësisë, Kryesues;
 - 2.2. Dr. Sc. Bedri Bahtiri, Zv.Kryesues;
 - 2.3. Prof. Dr. Abdulla Aliu, Anëtar;
 - 2.4. Prof. Dr. Faik Brestovci, Anëtar;
 - 2.5. Prof. Dr. Iset Morina, Anëtar;
 - 2.6. Prof. Dr. Nerxhivane Dauti, Anëtare;
 - 2.7. Prof. Dr. Asllan Bilalli, Anëtar;
 - 2.8. Prof. Dr. Hamdi Podvorica, Anëtar;
 - 2.9. Prof. Dr. Haxhi Gashi, Anëtar;
 - 2.10. Prof. Dr. Robert Muharremi, Anëtar;
 - 2.11. Prof. Dr. Rustem Qehaja, Anëtar;
 - 2.12. Sefadin Blakaj, Anëtar;
 - 2.13. Rexhep Haxhimusa, Anëtar;
 - 2.14. Erdogan Haxhibeqiri, Anëtar;
 - 2.15. Ymer Hoxha, Anëtar;
 - 2.16. Muhamet Rexha, Anëtar;
 - 2.17. Muharrem Shala, Anëtar;
 - 2.18. Ilaz Ramajli, Anëtar;
 - 2.19. Ferid Gjikolli, Anëtar;
 - 2.20. Lazim Salihu, Anëtar;
 - 2.21. Adem Vokshi, Anëtar;
 - 2.22. Qazim Qerimi, Anëtar;
 - 2.23. Virtyt Ibrahimaga, Anëtar;
 - 2.24. Ruzhdi Berisha, Anëtar dhe
 - 2.25. Lulzim Aliaj, Anëtar.
3. Për sekretar të Komisionit emërohet Lulzim Aliaj.

4. Komisioni themelohet me qëllim të kodifikimit të së drejtës civile dhe hartimit të draftit të Kodit Civil.
5. Me qëllim të kryerjes efikase të aktivitetit të tij, Komisioni mund të formojë grupe punuese të përkohshme apo të përhershme si dhe mund të angazhojë ekspert nga fusha e të drejtës civile.
6. Në punën e tij, Komisioni mund të shfrytëzojë mbështetjen profesionale të organizatave dhe institucioneve përkatëse vendore dhe ndërkombëtare.
7. Komisioni mund të nxjerr rregulloren për punën e tij.
8. Komisioni është i obliguar që për punën e tij, çdo gjashtë muaj t'i raportojë Qeverisë.
9. Komisioni është i obliguar që Ministrisë së Drejtësisë t'ia dërgojë tekstin e draft Kodit Civil në afat prej 24 muaj nga dita e nënshkrimit të këtij Vendimi.
10. Qeveria e Republikës së Kosovës ndanë mjete financiare Ministrisë së Drejtësisë për punën e Komisionit.
11. Lartësia e kompensimit për punën e anëtarëve të Komisionit dhe të sekretarit të Komisionit do të caktohet me vendim të Ministrit të Drejtësisë.
12. Ministria e Drejtësisë obligohet për sigurimin e kushteve materiale, teknike dhe kushteve tjera për punën e Komisionit.
13. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë